

Regjistrimi Civil

Procedura për regjistrim dhe marrjen e certifikatave

- [Certifikata e lindjes](#)
 - [Certifikatë jete](#)
 - [Certifikata e statusit martesor](#)
 - [Certifikatë martese](#)
 - [Certifikatë vendbanimi](#)
 - [Certifikatë për lidhje martese](#)
 - [Certifikatë vdekjeje](#)
 - [Certifikata e bashkësisë familjare](#)
-

Shtetësia

Kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për Shtetësinë e Kosovës. Pritet të hyjnë në fuqi UA-të. Zyra për Shtetësi është themeluar me Vendim të Ministrit të MPB-së, jemi në proces të regrutimit të stafit.

Certifikata e lindjes

Nëse jeni të regjistruar, mund t`ia bëni kërkesën zyrtarit të gjendjes civile në të cilën ndodhet regjistri i të lindurve për ju.

Në secilën dosje të Regjistrimit të Lindjes duhet të gjendet komplet dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e lindjes. Dokumentacioni që përmban dosja ndryshon varësisht nëse lindja ka ndodhur në institucion shëndetësor, jashtë institucionit shëndetësor apo jashtë vendit.

Nëse konstatohet se në dosjen e regjistrimit të lindjes gjenden:

- Kërkesa për regjistrimin e lindjes,
- Fletë lëshimi i institucionit shëndetësor publik apo privat ku ka ndodhur lindja,
- Certifikata e martesës për prindërit e fëmijës,
- Procesverbali për pranimin e atësisë, nëse fëmija është jashtëmartesor,
- Fotokopjet e dokumenteve të identifikimit për prindërit e fëmijës. Për fëmijët e braktisur, vërtetimi i organit të kujdestarisë.

- Për fëmijën e lindur jashtë institucioneve shëndetësore (në shtëpi) lëshohet, në dosjen e regjistrimit të lindjes duhet të gjenden këto dëshmi:

- Kërkesa për regjistrimin e lindjes,
- Vërtetimi i institucionit shëndetësor për vaksinimin e kryer,
- Certifikata e martesës për prindërit e fëmijës,
- Procesverbali për pranimin e atësisë, nëse fëmija është jashtëmartesor,
- Deklarata e së paku dy dëshmitarëve që kanë asistuar gjatë lindjes apo kanë njohuri të drejtpërdrejta për lindjen e fëmijës jashtë institucionit shëndetësor,
- Fotokopjet e dokumenteve të identifikimit të prindërve të fëmijës.

- Për certificate të lindjes për fëmijën e lindur jashtë territorit të Kosovës duhet që në dosjen e regjistrimit të lindjes gjenden:

- Kërkesa për regjistrimin e lindjes,

- Certifikata e lindjes internacionale apo ekuivalenti i lëshuar nga shteti i lindjes,
- Certifikata e martesës për prindërit e fëmijës,
- Procesverbali për pranimin e atësisë, nëse fëmija është jashtëmartesor,
- Fotokopjet e dokumenteve të identifikimit të prindërve të fëmijës.

Certifikata e lindjes, vlen për afat të pakufizuar, nëse nuk pëson ndryshime në të dhëna, përveç në rastin kur përdoret për martesë sipas LSC.

Certifikatë jete

Personi duhet të jetë prezent në ZGJC, duhet ta bëjë kërkesën dhe duhet të posedojë dokument identifikimit.

Certifikata vlen 6 muaj nga data e lëshimit.

Shtetësia

Nëse jeni të regjistruar në regjistrin e shtetasve të Kosovës, mund t`ia bëni kërkesën zyrtarit të gjendjes civile në të cilën ndodhet regjistri i shtetasve për ju.

Kjo çështje është e rregulluar me Ligjin për Shtetësinë e Kosovës. Pritet të hyjnë në fuqi UA-të. Ende nuk ka filluar zbatimimi i këtij Ligji, në pritje të UA-ve.

Certifikata e statusit martesor

Certifikata e statusit martesor është dokument zyrtar që e lëshon Zyra e Gjendjes Civile, në bazë të dhënave nga regjistri i lindjes, sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të personit të interesuar.

Ndërsa, në rastet kur nuk ekziston regjistri i të lindurve, lëshohet në bazë të deklaratave të dy dëshmitarëve dhe kopjes së dokumentit të identifikimit të paraqitësit të kërkesës dhe dëshmitarëve.

Nëse gjendja martesore e tij/saj është e shkurorëzuar duhet vendimi i shkurorëzimit.

Certifikata e statusit martesor, vlen 6 muaj nga data e lëshimit.

Certifikatë martese

Nëse jeni të regjistruar në regjistrin e të martuarve, mund t`ia bëni kërkesën zyrtarit të gjendjes civile në të cilën ndodhet regjistri i të martuarve për ju.

Certifikata e martesës, vlen deri sa nuk ka ndryshime në të dhënat.

Certifikatë vendbanimi

Nëse jeni të regjistruar në regjistrin e vendbanimit, mund t`ia bëni kërkesën zyrtarit të gjendjes civile në të cilën ndodhet regjistri i vendbanimit për ju.

Ende nuk kanë hyrë në fuqi UA për zbatimin e Ligjit për vendbanimin.

Certifikatë për lidhje martese

Certifikata e martesës, kapaciteti martesor, është dokument zyrtar që e lëshon Zyra e Gjendjes Civile, në bazë të dhënave nga regjistri i të martuarve, sipas detyrës zyrtare apo me paraqitjen e kërkesës me shkrim.

Nëse qytetari i huaj e ka fituar shtetësinë e Kosovës dhe lidhë martesë jashtë shtetit, dihet ta

nxjerrë certifikaten me aftësi ligjore për të lidh martesë jashtë shteti (kapaciteti martesor).
Certifikata e martesës, vlen 6 muaj nga data e lëshimit.

Certifikatë vdekjeje

Nëse personi në fjalë është i regjistruar në regjistrin e të vdekurve, mund t`ia bëni kërkesën zyrtarit të gjendjes civile në të cilën ndodhet regjistri i të vdekurve.
Nëpunësi kompetent duhet ta bëjë verifikimin e drejtpërdrejtë në regjistrin përkatës të gjendjes civile apo në dosjen fizike pas konstatimit se janë plotësuar këto kushte:

- Kërkesa për regjistrimin e vdekjes,
- Vërtetimi mbi vdekjen nga institucioni shëndetësor, nëse vdekja ka ndodhur në institucionin shëndetësor publik ose privat,
- Certifikata e lindjes,
- Certifikata e martesës për ata që kanë qenë të martuar.
- Fotokopja e dokumentit të identifikimit ose dokumenti i udhëtimit i personit për të cilin kërkohet certifikata,
- Dëshmia e dy dëshmitarëve që e kanë parë me sy të vdekurin ose e kanë bërë identifikimin e kufomës pa ndonjë dyshim nëse vdekja ka ndodhur jashtë institucionit shëndetësor.
- Certifikata e vdekjes, internacionale ose ekuivalenti, nga shteti ku ka ndodhur vdekja, kur vdekja ka ndodhur jashtë,
- Certifikata e vdekjes e lëshuar vetëm pasi jetë bërë regjistrimi në regjistrin e gjendjes civile të të vdekurve.

Nëse vdekja ndodhë jashtë shtetit, duhet certifikata origjinale e vdekjes e lëshuar nga shteti i huaj, kopja e dokumentit të identifikimit të personit të vdekur dhe kopja e dokumentit të paraqitësit të kërkesës për regjistrimin e faktit të vdekjes.
Certifikata e vdekjes, vlen përgjithmonë.

Certifikata e bashkësisë familjare

Deklaratën e bashkësisë familjare, e lëshon Zyra e Gjendjes Civile sipas detyrës zyrtare ose pas kërkesës me shkrim nga personi i interesuar.
Nëse kërkuesi ka dikë që është i varur prej tij dhe duhet cekur në certifikatë, atëherë personat duhet të jenë pranishëm dhe të prezantojnë kopjet e dokumenteve të identifikimit të tyre.
Certifikata mbi bashkësinë familjare vlen 6 muaj nga data e lëshimit.